



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 pika (d), lidhur me nenin 40 paragrafi 2, pika (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të dispozitave të Ligji Nr. 04/-l-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 22/2011”, e në zbatim të nenit 31, Rregullores (QRK) - Nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, e konform nenit 29 dhe 54 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, ----- miratoi këtë;

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim miratohet raporti i Komisionit komunale për vlerësimin e dëmeve të shkatuara nga vërshimet e dateës 06, 07 dhe 08 janar 2026.

Neni 2

Pjesë përbërës e këtij vendimi është edhe raporti i Komisionit komunale për vlerësimin e dëmeve të shkatuara nga vërshimet e dateës 06, 07 dhe 08 janar 2026, me numër të protokollit 01-Nr-052-8338, të datës 16.02.2026, i hartuar nga komisioni i lartcekur.

Neni 3

Obligohet Kryetari i Komunës së Suharekës që raportin e Komisionit komunale për vlerësimin e dëmeve të shkatuara nga vërshimet e dateës 06, 07 dhe 08 janar 2026 me komplet dokumentat përcjellse ta dorzon Agjencisë së Menaxhimit Emergjent në Prishtinë dhe një kopje ia dorzon Komisionit qendror për vlersimin e dëmeve.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI